

## PLAN VEPRIMI

### Për Zhvillim të Qëndrueshëm, Ekonomi Qarkulluese dhe Menaxhim Risku në Kompani

#### 1. Informacion i Përgjithshëm për Kompaninë

Emri i biznesit është FITO FARM, një biznes privat që operon në sektorin e agrobiznesit. Kompania përfshin aktivitete të integruara në zinxhirin e vlerës bujqësore, duke kombinuar furnizimin me inpute bujqësore, kultivimin e agrumeve dhe eksportin e këtyre agrumeve.

FITO FARM ka të punësuar 7 punonjës gjatë pjesës më të madhe të vitit. Gjatë sezonit të vjeljes dhe eksportit të agrumeve, numri i punonjësve shkon deri në 25-30 punonjës, për shkak të nevojave shtesë për vjelje, seleksionim dhe përgatitje për eksport.

Për sa i përket organizimit, biznesi nuk funksionon me sektorë apo departamente të ndara formalisht, por me një strukturë të thjeshtë dhe praktike, ku puna organizohet sipas proceseve ditore. Menaxhimi dhe koordinimi i shumicës së proceseve si importi, magazinimi, kultivimi i agrumeve dhe organizimi i eksportit mbulohet kryesisht nga pronarët/menaxhuesit e biznesit. Ndërkohë farmacia bujqësore dhe shitjet me pakicë në ambientin e magazinës realizohen nga një punonjëse, e cila kujdeset për shërbimin, informimin dhe konsultimin e fermerëve mbi problemet dhe nevojat e përditshme. Ky model organizimi fleksibël dhe i thjeshtë i përshtatet natyrës së biznesit dhe i mundëson të funksionojë me efikasitet, sidomos gjatë periudhave sezonale.

Biznesi bën pjesë në sektorin e agrobiznesit dhe agroushqimit. Nën sektorët kryesor të aktivitetit janë

1. Inpute bujqësore- Import dhe tregti:
  - Import i plehrave kimike
  - Import i pesticideve
  - Shitje me shumicë (kryesisht e plehrave kimike) dhe pakicë
2. Farmaci bujqësore
  - Operimi i një farmacie bujqësore në të njëjtin ambient me qëllim këshillimin dhe orientimin e përdorimit të preparateve.
3. Prodhim bujqësor
  - Kultivim agrumesh në tokë në pronësi të biznesit në një sipërfaqe prej 5ha
  - Produktet e kultivuara: manderina dhe portokalle
4. Eksport agrumesh
  - Përgatitje dhe tregëtim i agrumeve për eksport rajonal (Kosovë dhe Maqedoni) dhe përmes ndërmjetësve në tregje më të gjera.

FITO FARM operon në tregun lokal, rajonal dhe ndërkombëtar. Në tregun vendas biznesi tregton plehra kimike dhe pesticide si me pakicë ashtu edhe me shumicë. Në tregun rajonal biznesi mundëson eksportin e agrumeve si në Kosovë dhe Maqedoni, ndërsa në tregun ndërkombëtar eksporti realizohet përmes ndërmjetësve tregtarë.

Proceset kryesore të kompanisë përfshijnë importin e plehrave kimike dhe pesticideve, magazinimin e tyre dhe shitjen përmes farmacisë bujqësore, e cila ndodhet në ambientet e magazinës së biznesit. Paralelisht, FITO FARM zhvillon aktivitetin e kultivimit të agrumeve në tokën bujqësore që ka në pronësi, duke përfshirë menaxhimin e parcelave, vjeljen, seleksionimin dhe përgatitjen e prodhimit për treg dhe eksport. Eksporti i agrumeve realizohet kryesisht gjatë muajve nëntor-janar, periudhë që përkon me sezonin kryesor të prodhimit. Biznesi disponon magazinën e vet për ruajtjen e produkteve, ndërsa shërbimi i transportit sigurohet përmes operatorëve të jashtëm me pagesë.

FITO FARM është e pozicionuar si një agrobiznes i integruar vertikalisht, duke kombinuar në të njëjtën strukturë furnizimin me inpute bujqësore, kultivimin e agrumeve dhe eksportin e produkteve bujqësore. Ky model i jep biznesit avantazh në kontrollin e cilësisë së produkteve dhe në menaxhimin e zinxhirit të operimit.

Ndër avantazhet konkurruese kryesore mund të përmendim njohjen e mirë të tregut bujqësor, marrëdhënie e qëndrueshme me fermerët dhe klientët, si dhe diversifikimi i aktivitetit ndërmjet tregtimit të inpueteve bujqësore, prodhimit bujqësor dhe eksportit të agrumeve. Prania në tregjet rajonale dhe bashkëpunimi me ndërmjetës për tregjet ndërkombëtare rrisin mundësitë e shitjes dhe zgjerimit në treg.

Megjithatë, ndërmarrja përballë me disa sfida, si sezonaliteti i prodhimit të agrumeve, kushtet klimatike, rritja e kostove të transportit, konkurrenca nga biznese të ngjashme në treg, si dhe kërkesat në rritje për standarte mjedisore dhe produkte më të qëndrueshme. Konkurentët kryesorë janë kompani të tjera që merren me importin e plehrave kimike dhe pesticideve si dhe agrobiznese që eksportojnë agrume në tregje rajonale.

## **2. Analiza e Qëndrueshmërisë në Kompani**

### **2.1. Analiza e situatës ekzistuese**

Te FITO FARM, për momentin nuk ka një dokument zyrtar ose politikë të shkruar për qëndrueshmërinë (psh një plan i posaçëm për mjedisin). Megjithatë, në praktikë proceset organizohen në mënyrë sa më të rregullt dhe miqësore me mjedisin. Biznesi nuk ka certifikime mjedisore si ISO14001 ose EMAS. Kjo si pasojë e madhësisë së biznesit dhe e kostove të larta, procedurave dhe monitorimit të vazhdueshëm që kërkojnë këto certifikime. Gjithsesi, drejtuesit përpiqen të respektojnë rregullat bazë ligjore gjatë zhvillimit të aktivitetit.

Menaxhimi i mbetjeve, ujit dhe energjisë:

- Mbetjet: Mbetjet kryesore që dalin nga aktiviteti janë ambalazhet e plehrave kimike dhe pesticideve, si dhe materiale të tjera nga magazina (karton, plastikë). Aktualisht ambalazhet hidhen, që është një pikë ku biznesi mund të përmirësohet, sidomos sepse ambalazhet e pesticideve mund të kenë ndikim negativ për mjedisin nëse nuk menaxhohen sic duhet.

- Uji: Tek kultivimi i agrumeve, ujitja bëhet me sistem me pika, që është një mënyrë më e mirë sepse ndihmon tek kursimi i ujit dhe nuk sjell shpërdorim të ujit si ujitja tradicionale.
- Energjia: Konsumi i energjisë lidhet kryesisht me punën në magazinë dhe farmacinë bujqësore (ndricim dhe pajisje bazë). Nuk ekziston ndonjë sistem i vecantë për kursimin e energjisë.

Në aktivitetin e saj FITO FARM tregëton inpute bujqësore (plehra kimike dhe pesticide), që janë të domosdoshme për tregun ku operon, por kanë ndikim të konsiderueshëm në mjedis nëse nuk menaxhohen me kujdes. Nga ana tjetër, biznesi ka disa praktika të thjeshta ripërdorimi, si psh paletat që vijnë plehurat kimike nga importi ripërdoren për ngarkesat e eksportit të agrumeve, ose punimi me arka disapërdorimshe. Këto praktika ulin sado pak sasinë e materialeve të hedhura dhe ulin kostot.

Biznesi siguron kushte bazë pune dhe organizon punën sipas nevojave sezonale. Në periudhën e vjeljes, kur punësohen më shumë punëtorë, rritet edhe nevoja për menaxhim më të mirë të sigurisë, sidomos në aktivitetet e vjeljes, ngarkim-shkarkimit dhe magazinimit. Aktualisht, udhëzimet për sigurinë jepen në mënyrë praktike dhe jo formale. Një përmirësim i arsyeshëm do të ishte standartizimi i disa rregullave bazë dhe trajnim minimal për sezonin sidomos për punonjës të rinj, pa eksperiencë të mëparshme.

Në FITO FARM, qëndrueshmëria nuk është e integruar si koncept i shkruar në objektivat vjetore apo politikat e brendshme, por është e pranishme në mënyrë indirekte në vendime praktike. Për shembull, përdorimi i ujitjes me pika dhe kursimi i burimeve bëhen edhe për arsye ekonomike, por njëkohësisht ndikojnë pozitivisht edhe në aspektin mjedisor. Megjithatë, për tu quajtur integrim i plotë do të duhej që biznesi të kishte disa rregulla dhe objektiva të qarta edhe sikur të ishin në nivel minimal.

Aktualisht, biznesi nuk përgatit raportim formal të qëndrueshmërisë dhe nuk mban indikatorë (si sasia e ujit e përdorur, konsumi i energjisë, sasia e mbetjeve). Me rritjen e kërkesave të tregut dhe standarteve të eksportit, raportimi bazë i disa treguesve bëhet i detyrueshëm dhe kjo mund të shërbejë si hap pozitiv për rritjen e besueshmërisë dhe për të ulur riskun në të ardhmen.

## **2.2. Analiza e palëve të interesit (Stakeholders)**

Palët kryesore të interesit për FITO FARM janë:

1. Pronarët/ menaxherët presin që kompania të jetë e qëndrueshme financiarisht dhe të sjellë fitim afatgjatë, duke shmangur probleme me ligjin apo me mjedisin. Ata janë ndikimi kryesor në vendimmarrje sepse cdo gjë kalon nga ata. Një konflikt mund të jetë investimi për qëndrueshmëri, por ky investim rrit shumë kostot.
2. Punonjësit presin kushte normale pune dhe siguri, sidomos në sezon ku ka më shumë punë. Ata kanë ndikim mesatar në vendimmarrje, por ndikim të drejtpërdrejt në efikasitetin operacional të biznesit. Bashkëpunimi i mirë me punonjësit është shumë i rëndësishëm për ruajtjen e produktivitetit dhe vazhdimësisë së aktivitetit.

3. Fermerët dhe klientët presin të blejnë produkte cilësore dhe këshillim profesional. Ndikimi i tyre në vendimmarrje është i konsiderueshëm, pasi preferencat dhe besimi i tyre ndikojnë të politikat e shitjes dhe reputacionin e biznesit. Bashkëpunimi me këtë grup është i rëndësishëm për të ruajtur marrëdhëniet afatgjata.
4. Partnerët tregtarë dhe ndërmjetësit e eksportit presin cilësi të qëndrueshme të agrumeve dhe respektim të afateve të dërgimit. Ata ndikojnë në planifikimin e eksporteve dhe aksesin në tregje, ndërsa konfliktet e mundshme mund të vijnë nga kushtet e tregut dhe kostot e transportit. Bashkëpunimi është i rëndësishëm për zgjerimin e tregut dhe stabilitetin e shitjeve.
5. Institucionet shtetërore dhe rregullatore presin respektim të legjislacionit mjedisor, tatimor dhe të sigurisë ushqimore. Ndikimi i tyre në vendimmarrje është i lartë përmes kontrolleve dhe kërkesave ligjore. Bashkëpunimi korrekt me institucionet redukton risqet ligjore.
6. Furnitorët presin marrëdhënie tregtare të qëndrueshme dhe pagesa korrekte, duke pasur ndikim në funksionimin e zinxhirit të furnizimit.
7. Komuniteti lokal pret punësim dhe ndikim pozitiv ekonomik, duke ndikuar kryesisht në reputacionin social të biznesit.

### **2.3. Sfidat aktuale të qëndrueshmërisë**

#### a) Sfidat mjedisore

Aktiviteti i FITO FARM lidhet drejtpërdrejt me sektorin e agrobiznesit, i cili ka ndikim të pashmangshëm në mjedis. Edhe pse produktet si plehrat kimike dhe pesticidet janë të domosdoshme për prodhimin bujqësor, ato përbëjnë një risk potencial për ndotjen e tokës dhe ujit nëse përdoren apo menaxhohen në mënyrë të pakontrolluar. Një problem konkret mund të përmendim menaxhimin e ambalazheve të pesticideve, të cilat aktualisht nuk trajtohen përmes ndonjë sistemi të organizuar grumbullimi apo riciklimi. Në aspektin e konsumit të ujit, përdorimi i sistemit të ujitjes me pika është një praktikë pozitive dhe ndihmon në kursimin e ujit.

#### b) Sfidat sociale

Disa elementë pozitiv që mund të përmendim nga ana sociale: paga në sezon është goxha e lartë dhe në punë të gjithë punonjësit trajtohen njësoj. Një sfidë mund të jetë që gjatë periudhës së vjeljes shtohet numri i punonjësve dhe një pjesë mund të jetë pa eksperiencë. Kjo rrit nevojën për më shumë siguri në punë, sidomos në vjelje dhe ngarkim-shkarkim.

#### c) Sfidat financiare për investime të gjelbra

Si një biznes i mesëm në sektorin e agrobiznesit, burimet financiare janë të kufizuara dhe prioritet kryesor mbetet sigurimi i stabilitetit dhe fitimit afatgjatë. Për këtë arsye, investimet që lidhen me qëndrueshmërinë mjedisore, si përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, kursimi i energjisë apo mekanizma për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit, shpesh shtyhen ose nuk ju jepet rëndësia e duhur.

Një tjetër sfidë është fakti që investimet e gjelbra kërkojnë kosto fillesatre, ndërkohë që përfitimet e tyre shfaqen në afatgjatë. Kjo e bën të vështirë marrjen e vendimeve për këto investime, sidomos në një biznes ku të ardhurat ndikohen nga sezonaliteti dhe kushtet e tregut. Për më tepër, mungesa e skemave mbështetëse ose informacionit të qartë mbi subvencionet dhe fondet për investime të gjelbra e kufizon dhe më shumë mundësinë për zbatimin praktik të këtyre iniciativave.

#### d) Sfidat operacionale

Në aspektin operacional, mund të përmendim si sfidë mënyrën tradicionale të funksionimit të biznesit. Proceset kryesore si magazinimi, menaxhimi i produkteve dhe organizimi i punës realizohen kryesisht në mënyrë manuale dhe pa përdorim të sistemeve dixhitale. Kjo e bën të vështirë matjen e efikasitetit dhe planifikimin më të saktë të aktivitetit.

Një tjetër sfidë lidhet me përdorimin e teknologjive relativisht të thjeshta dhe të vjetëruara, sidomos në proceset e përgatitjes për eksport. Mungesa e investimeve në pajisje moderne mund të ndikojë në humbje kohe dhe rritje të kostove operative.

#### e) Rezistenca ndaj ndryshimit nga drejtuesit apo punonjësit

Rezistenca ndaj ndryshimit në FITO FARM nuk shfaqet në formë të hapur, por më tepër si hezitim për të ndryshuar mënyrën aktuale të funksionimit. Cdo ndryshim që kërkon kohë apo investim shtesë shihet me kujdesë apo shtyhet për më vonë. Kjo lidhet më shumë me frikën nga rritja e kostove dhe pasiguria mbi përfitimet e menjëhershme të këtyre ndryshimeve.

Nga ana tjetër, edhe punonjësit janë mësuar me mënyrët tradicionale të punës dhe mund të kenë vështirësi në përshtatje me rregulla të reja, trajnime apo procedura të formalizuara.

#### f) Pengesa legislative apo rregullatore

Nga ana legislative dhe rregullatore, biznesi operon brenda cdo kufiri ligjor dhe ka qenë subjekt i kontroleve nga institucioneve përkatëse, si AKU dhe administrata tatimore, pa pasur gjoba apo paralajmërime. Megjithatë, një pengesë e mundshme lidhet me ndryshimet e shpeshta të legjislacionit në fushën mjedisore dhe sigurinë ushqimore.

Gjithashtu, zbatimi i standarteve të reja mjedisore ose sociale mund të kërkojë investime shtesë dhe dokumentacion të detajuar, gjë që mund të përbëjë vështirësi për një kompani me strukturë të thjeshtë organizative.

### **3. Identifikimi i Objektivave Strategjike për Qëndrueshmëri**

Objektivat e paraqitura më poshtë nuk përfaqësojnë objektiva aktualisht të formalizuara apo të zbatuara nga kompania, por janë objektiva të propozuara dhe të rekomanduara, të hartuara në kuadër të kësaj analize, bazuar në situatën ekzistuese dhe sfidat kryesore të identifikuara.

1. Objektiv i parë është përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, vecanërisht i ambalazheve të pesticideve dhe plehrave kimike. Brenda 24 muajve, FITO FARM synon të krijojë një sistem bazë për grumbullimin dhe ndarjen e ambalazheve, si dhe të bashkëpunojë me subjekte për trajtimin e tyre. Ky objektivi është specifik dhe i matshëm përmes sasisë së ambalazheve të

grumbulluara, i realizueshëm për shkak të kostove relativisht të ulëta dhe kontribuon në uljen e ndotjes mjedisore. Ai lidhet drejtpërdrejt me SDG 12 (Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm) dhe mbështet kalimin drejt ekonomisë qarkulluese përmes riciklimit dhe ripërdorimit të materialeve. Në të njëjtën kohë, ky objektivi ndihmon në reduktimin e risqeve mjedisore dhe ligjore duke përmirësuar performancën afatgjatë dhe besueshmërinë e kompanisë.

2.Objektivi i dytë lidhet me përmirësimin e sigurisë dhe mirëqenies së punonjësve, sidomos gjatë periudhave sezonale. Brenda 12 muajve, kompania synon të hartojë dhe zbatojë rregulla të thjeshta të shkruara për sigurinë në punë dhe të ofrojë orientim të shkurtër për punonjësit sezonalë. Ky objektivi është i matshëm përmes numrit të trajnimeve dhe uljes së incidenteve në punë, i arritshëm dhe i rëndësishëm për ruajtjen e produktivitetit. Ai lidhet me SDG 8 (Punë e denjë dhe rritje ekonomike) dhe kontribuon në performancën afatgjatë duke rritur motivimin dhe stabilitetin e fuqisë punëtore. Përmes uljes së aksidenteve dhe përmirësimit të organizimit të punës, ky objektivi redukton risqet sociale dhe operacionale dhe mbështet një përdorim më efikas të burimeve njerëzore.

3.Objektivi i tretë është rritja e efikasitetit në përdorimin e burimeve, kryesisht ujit dhe energjisë. Brenda 18 muajve, FITO FARM synon të monitorojë konsumin e ujit dhe energjisë dhe të zbatojë masa të thjeshta kursimi, si përdorimi i ndricimit LED dhe optimizimi i proceseve në magazinë. Ky objektivi është i matshëm përmes uljes së konsumit, i realizueshëm pa investime të mëdha dhe kontribuon drejtpërdrejt në uljen e kostove operative. Ai lidhet me SDG 6 (Ujë i pastër dhe menaxhim i qëndrueshëm) dhe SDG 7 (Energji e pastër dhe e përbalueshme), duke mbështetur ekonominë qarkulluese përmes përdorimit më racional të burimeve natyrore. Gjithashtu, ky objektivi redukton risqet financiare dhe mjedisore që lidhen me rritjen e kostove dhe përdorimin e pakontrolluar të burimeve.

## **4. Analiza dhe Hartimi i Riskut**

### **4.1. Identifikimi i Riskut**

#### **Risqet mjedisore**

Risku më i madh mjedisor lidhet me ruajtjen dhe menaxhimin e pesticideve dhe plehrave kimike në magazinë, sepse cdo derdhje, rrjedhje apo trajtim i gabuar mund të ndikojë tokën dhe ujërat përreth. Një tjetër risk konkret është menaxhimi i mbetjeve, sidomos ambalazhet e pesticideve, të cilat janë potencialisht të rrezikshme dhe aktualisht nuk kanë një sistem të organizuar grumbullimi/riciklimi. Në pjesën e fermës, risk mjedisor mbetet përdorimi i inputeve bujqësore (plehra/pesticide) në parcelë, ku përdorimi i pakontrolluar mund të ndikojë cilësinë e tokës dhe ujit.

#### **Risqet sociale**

Në aspektin social, risku kryesor është siguria dhe shëndeti në punë, sidomos gjatë sezonit të vjeljes dhe përgatitjes për eksport, kur rritet numri i punonjësve dhe puna është fizike (vjelje,

seleksionim, ngarkim-shkarkim). Sic është përmendur, udhëzimet e sigurisë jepen më shumë praktikisht dhe jo të formalizuara cka rrit mundësinë e incidenteve. Risk social mund të jetë lodhja dhe ritmi i lartë i punës në sezon, që ndikon mirëqenien. Një tjetër risk social është ekspozimi i punonjësve ndaj kushteve klimatike nëse nuk respektohen masat bazë (pajisje mbrojtëse, ruajtje e sigurt).

### **Risqet financiare**

Risqet financiare lidhen me sezonalitetin dhe varësinë nga të ardhurat e eksportit të agrumeve në periudha të caktuara, gjë që e bën biznesin më të ndjeshëm ndaj luhatjeve të tregut dhe cmimeve. Një risk tjetër është rritja e kostove të transportit (sidomos për eksportin), pasi biznesi përdor operatorë të jashtëm me pagesë. Po ashtu, luhatjet e cmimeve në inputet bujqësore (plehra/pesticide) mund të ndikojnë marzhin e fitimit. Kosto shtesë mund të dalin edhe nga nevoja për përmirësime të detyrueshme (p.sh. menaxhim mbetjesh, pajisje sigurie) nëse kërkesat rregullatore bëhen më të forta.

### **Risqet ligjore**

Në risqet ligjore përfshihen risqet që lidhen me përputhshmërinë në magazinim dhe tregtim të kimikateve bujqësore (ruajtja e sigurt, etiketimi, dokumentacioni). Gjithashtu, risk ligjor është menaxhimi jo i duhur i ambalazheve të pesticideve, sepse mund të sjellë probleme në rast kontrollesh.

### **Risqet operacionale**

Risku kryesor operacional është organizimi i sezonit: cdo vonesë në vjelje, seleksionim, magazinim ose ngarkim mund të ndikojë direkt në cilësi dhe në afatet e eksportit. Varësia nga punonjës sezonalë rrit riskun e mungesës së fuqisë punëtore ose uljes së produktivitetit në periudhat me ngarkesë. Një tjetër risk operacional është varësia nga transporti i jashtëm, sepse vonesat, mungesa e mjeteve ose rritja e tarifave ndikojnë procesin.

### **Risqet reputacionale**

Një risk reputacional do të ishte nëse klientët perceptojnë që kompania nuk këshillon si duhet përdorimin e pesticideve/plehrave, ose nëse ndodh ndonjë problem i dukshëm me mbetje/kimikate. Gjithashtu, në eksport reputacioni mund të dëmtohet nëse cilësia e agrumeve nuk është e qëndrueshme ose ka vonesa në dorëzim.

### **Pyetje shtesë**

- A ka kompania burime të cenueshme?

FITO FARM ka disa burime të cenueshme, si toka bujqësore ku kultivohen agrumet, uji i përdorur për ujtitje, magazina ku ruhen plehrat kimike dhe pesticidet, si dhe fuqia punëtore sezonale. Cdo problem që lidhet me këto burime mund të ndikojë drejtpërdrejt në prodhim, organizimin e punës dhe performancën e përgjithshme të biznesit.

- A ndikon ndryshimi i klimës tek kompania?

Ndryshimi i klimës përbën një nga risqet natyrore më të rëndësishme për aktivitetin e FITO FARM, pasi ndikon drejtpërdrejt në prodhimin bujqësor dhe stabilitetin ekonomik të kompanisë. Sektori i agrobiznesit është veçanërisht i ndjeshëm ndaj faktorëve klimatikë, sepse rendimenti, cilësia dhe sasia e prodhimit varen nga kushtet natyrore.

Fenomene si thatësirat e zgjatura dhe rritja e temperaturave mesatare ndikojnë negativisht në zhvillimin e agrumeve, duke ulur rendimentin dhe duke rritur nevojën për ujitje intensive. Kjo sjell rritje të kostove operative dhe presion mbi burimet ujore. Për më tepër, reshjet e parregullta dhe intensiteti i lartë i tyre mund të shkaktojnë erozion të tokës, përmytje lokale dhe dëmtim të strukturës së tokës bujqësore, duke ndikuar në produktivitetin afatgjatë të fermës.

Një tjetër risk natyror i rëndësishëm janë fenomenet ekstreme klimatike, si ngricat, breshëri dhe stuhitë. Ngricat e papritura mund të dëmtojnë pemët e agrumeve dhe lulet, duke reduktuar ndjeshëm prodhimin sezonal. Breshëri, nga ana tjetër, mund të shkaktojë dëme direkte në fruta, duke ulur cilësinë e tyre dhe duke bërë që një pjesë e prodhimit të mos jetë e përshtatshme për treg ose eksport. Këto fenomene jo vetëm që ndikojnë në sasinë e prodhimit, por edhe në reputacionin e kompanisë në tregjet e eksportit, ku kërkohet cilësi e qëndrueshme e produkteve.

Ndryshimet klimatike ndikojnë gjithashtu në rritjen e pasigurisë dhe paparashikueshmërisë së prodhimit bujqësor. Kjo e bën planifikimin e aktivitetit më të vështirë dhe rrit riskun financiar për kompaninë, pasi të ardhurat varen nga faktorë që janë jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të menaxhimit.

- A mund të ndikojë rritja e çmimit të energjisë në operacione?

Rritja e çmimit të energjisë elektrike nuk ndikon shumë në operacionet e FITO FARM, pasi konsumi i saj është relativisht i ulët dhe lidhet kryesisht me ndricimin dhe pajisjet bazë në magazinë dhe farmacinë bujqësore.

- Sa i qëndrueshëm është zinxhiri i furnizimit?

Zinxhiri i furnizimit i FITO FARM konsiderohet i qëndrueshëm, pasi biznesi ka vite që operon në treg dhe ka krijuar marrëdhënie të forta dhe afatgjata me furnitorët e inputeve bujqësore dhe me partnerët e transportit dhe tregtimit.

## 4.2. Analiza dhe Vlerësimi i Riskut

Risku	Probabiliteti	Ndikimi	Nivel Risku	Koment
Menaxhimi i pesticideve dhe ambalazheve	I lartë	I lartë	I lartë	Risk mjedisor dhe ligjor
Siguria dhe mirëqenia e punonjësve në sezon	I ulët	Mesatar	Mesatar	Punë fizike intensive
Kushtet klimatike (thatësi, ngrica, breshër)	Mesatar	I lartë	I lartë	Ndikon prodhimin
Sezonaliteti i të ardhurave	Mesatar	Mesatar	Mesatar	Varësi nga eksporti
Kostot e transportit	I ulët	I ulët	I ulët	Operatorë të jashtëm
Përputhshmëria ligjore dhe dokumentimi	I ulët	I lartë	Mesatar	Kontroll dhe standarde
Organizimi i procesit të eksportit	I lartë	Mesatar	I lartë	Afate dhe cilësi
Varësia nga furnitorë/transporti jashtëm	I ulët	I lartë	Mesatar	Risk kontrolluar
Risk reputacional	I ulët	I lartë	I lartë	Besimi i klientëve

#### 4.3. Matrica e Riskut (Risk Map)

Probabiliteteti	I lartë		Organizimi i procesit të eksportit	Menaxhimi i pesticideve dhe ambalazheve të tyre
	Mesatar		Sezonaliteti i të ardhurave	Kushtet klimatike (thatësi, ngrica, breshër)
	I ulët	Kostot e transportit	Siguria dhe mirëqenia e punonjësve në sezon	1.Përputhshmëria ligjore dhe dokumentimi 2.Risk reputacional 3.Varësia nga furnitorë
		I ulët	Mesatar	I lartë
		<b>Ndikimi</b>		

a) Cilat janë 3 Risqet më kritike?

Bazuar në vlerësimin e probabilitetit dhe ndikimit, tre risqet më kritike për FITO FARM janë:

1. Menaxhimi i pesticideve dhe ambalazheve të tyre, për shkak të ndikimit të lartë mjedisor dhe ligjor. Mund të shkaktojnë ndotje të tokës dhe ujit, probleme ligjore në rast kontrollesh dhe dëmtim të reputacionit të kompanisë.
2. Kushtet klimatike (thatësi, ngrica, breshër), të cilat ndikojnë drejtpërdrejt prodhimin e agrumeve dhe të ardhurat nga eksporti. Mund të ulin rendimentin dhe cilësinë e agrumeve, duke sjellë humbje financiare dhe pasiguri në të ardhurat sezonale.
3. Organizimi i procesit të eksportit, ku cdo vonesë në vjelje, seleksionim ose transport ndikon cilësinë dhe respektimin e afateve. Mund të shkaktojë vonesa, humbje klientësh, penalitete kontraktuale dhe dëmtim të marrëdhënieve me partnerët tregtarë.

b) Pse ndodhen në zonën e kuqe?

Këto risqe ndodhen në zonën e kuqe sepse kombinojnë ndikim të lartë me probabilitet mesatar deri të lartë. Ato lidhen drejtpërdrejt me proceset kryesore të biznesit (menaxhimi i inputeve, prodhimi bujqësor dhe eksporti) dhe, nëse ndodhin, mund të ndikojnë seriozisht funksionimin, financat dhe reputacionin e FITO FARM.

c) A ka risk të nënvlerësuar?

Një risk që mund të konsiderohet i nënvlerësuar është përputhshmëria ligjore dhe dokumentimi. Edhe pse aktualisht biznesi nuk ka pasur gjopa apo paralajmërime, mungesa e dokumentimit formal dhe raportimit të treguesve të qëndrueshmërisë mund të kthehet në problem në të ardhmen, sidomos me rritjen e kërkesave ligjore dhe standardeve të eksportit.

d) Cilat Risqet mund të rriten në 5 vitet e ardhshme?

Në 5 vitet e ardhshme, pritet të rriten:

- Risqet klimatike, për shkak të ndryshimeve klimatike dhe fenomeneve ekstreme gjithnjë e më të shpeshta.
- Risqet ligjore dhe rregullatore, pasi priten standarde më të forta mjedisore dhe sociale për sektorin e agrobiznesit.
- Risqet financiare të lidhura me kostot e transportit dhe inputeve bujqësore, si pasojë e luhatjeve të tregut dhe çmimeve ndërkombëtare.
- Risku i mungesës së forcës punëtore.

#### **4.4. Strategjitë e Trajtimit të Riskut**

- Për riskun e menaxhimit të pesticideve dhe ambalazheve të tyre, eliminimi nuk është i mundur sepse këto produkte janë pjesë e aktivitetit. Strategjia më efektive është reduktimi i riskut, pasi me masa të thjeshta dhe me kosto të ulët mund të ulët ndjeshëm mundësia e ndotjes dhe e problemeve ligjore. Zbatimi kërkon kryesisht organizim të ruajtjes në magazinë, grumbullim të ndarë të ambalazheve dhe dorëzim të tyre për trajtim të kontrolluar. Përfitimet janë të larta sepse shmangen dëmet mjedisore, ulen risqet ligjore dhe përmirësohet reputacioni i kompanisë, ndërsa kostot lidhen me materiale bazë grumbullimi dhe pak kohë shtesë organizimi. Përgjegjësia i takon menaxhimit të kompanisë dhe personave që merren me magazinën/farmacisë bujqësore. Kërkohet vetëm orientim i shkurtër praktik për stafin (sidomos për punonjësit sezonalë), ndërsa teknologjia mund të përdoret në formë shumë të thjeshtë, si etiketime dhe mbajtje e një regjistri bazë për kontroll më të mirë.
- Për riskun klimatik (thatësi, ngrica, breshër), eliminimi nuk është i mundur sepse është jashtë kontrollit të biznesit. Qasja më e përshtatshme është kombinimi i reduktimit me transferimin. Reduktimi realizohet përmes planifikimit të ujitjes dhe organizimit të punës në periudhat kritike, ndërsa transferimi bëhet përmes sigurimeve bujqësore që mbulojnë një pjesë të humbjeve financiare kur ndodhin dëme nga fenomene natyrore. Kjo strategji është efektive sepse ul ndikimin praktik në prodhim dhe njëkohësisht mbron biznesin financiarisht. Kostot janë mesatare, pasi sigurimi dhe disa masa parandaluese kërkojnë shpenzime, por përfitimi është stabilitet më i madh i të ardhurave dhe ulje e pasigurisë financiare. Përgjegjësia kryesore për këtë risk është e pronarëve/menaxhimit të fermës.
- Për riskun e organizimit të procesit të eksportit, eliminimi nuk është realist pasi eksporti është aktivitet kyc. Strategjia më efektive është reduktimi, sepse problemet më të

zakonshme vijnë nga vonesat dhe koordinimi. Reduktimi arrihet përmes planifikimit më të saktë të sezonit, ndarjes së qartë të detyrave, koordinimit të punonjësve dhe komunikimit të vazhdueshëm me transportuesit dhe partnerët. Kostot janë të ulëta sepse lidhen kryesisht me organizim dhe koordinim, ndërsa përfitimet janë të larta sepse ruhet cilësia e agrumeve, respektohen afatet dhe mbahen marrëdhënie të qëndrueshme tregtare. Përgjegjës për zbatimin është menaxhimi i kompanisë. Trajnim formal nuk është i domosdoshëm, por orientimi i stafit sezonal dhe rregulla të thjeshta pune ndihmojnë. Teknologjia mund të përdoret në formë të thjeshtë për planifikim dhe komunikim (p.sh. koordinim me telefon/mesazhe dhe mbajtje e një plani pune), duke ulur riskun e vonesave.

Nga risqet e tabelës, një risk që mund të pranohet është rritja e kostove të transportit, pasi probabiliteti vlerësohet i ulët dhe ndikimi menaxhohet kryesisht përmes operatorëve të jashtëm. Ndërsa në këtë listë nuk ka risk që të eliminohet plotësisht, sepse shumica lidhen me natyrën e aktivitetit.

## **5. Plani i Veprimit mbi Qëndrueshmërinë**

Objektivi 1: Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve dhe ambalazheve të pesticideve dhe plehrave kimike. Për arritjen e këtij objektivi, FITO FARM duhet të vendosë pika të ndara për grumbullimin e ambalazheve të pesticideve dhe plehrave kimike në ambientet e magazinës. Këto ambalazhe duhet të ndahen sipas llojit dhe të ruhen në mënyrë të sigurt për të shmangur rrjedhje apo ndotje. Mungesa e një sistemi të organizuar grumbullimi rrit riskun e ndotjes së tokës dhe ujit, si dhe riskun e penalteteve ligjore në rast kontrollesh. Në afat të gjatë, ky objektivi ndikon në uljen e qëndrueshme të riskut mjedisor dhe ligjor. Një sistem i rregullt i menaxhimit të mbetjeve ul ndikimin negativ në mjedis dhe forcon reputacionin si një biznes i përgjegjshëm dhe i qëndrueshëm.

Objektivi 2: Përmirësimi i sigurisë dhe mirëqenies së punonjësve, vecanërisht në periudhat sezonale. Hartimi i rregullave bazë të shkruara për sigurinë në punë, të përshtatura për proceset e vjeljes, seleksionimit dhe magazinimit. Zbatimi i këtij objektivi në afat të gjatë ul numrin e aksidenteve në punë, rrit stabilitetin e fuqisë punëtore dhe përmirëson produktivitetin.

Objektivi 3: Rritja e efikasitetit në përdorimin e burimeve. Në afatgjatë, rritja e efikasitetit në përdorimin e ujit dhe energjisë ndihmon në uljen e kostove operative dhe rrit qëndrueshmërinë financiare të kompanisë. Kjo e bën biznesin më rezistente ndaj rritjes së cmimeve të energjisë dhe burimeve, duke ulur njëkohësisht ndikimin negativ në mjedis dhe duke forcuar qëndrueshmërinë e përgjithshme të biznesit.

### **5.2. Burimet e nevojshme**

Zbatimi i planit të veprimit mbi qëndrueshmërinë në FITO FARM kërkon burime financiare, teknologjike dhe njerëzore të kufizuara dhe të përshtatura me kapacitetet reale të biznesit. Investimet financiare janë të ulëta dhe lidhen kryesisht me materiale bazë për grumbullimin e mbetjeve, pajisje minimale sigurie për punonjësit dhe përmirësime të thjeshta për kursimin e

energjisë, si ndricimi LED. Teknologjia e nevojshme është praktike dhe nuk kërkon sisteme të avancuara, ndërsa burimet njerëzore mbështeten kryesisht te stafi ekzistues dhe menaxhimi i kompanisë.

### 5.3. Indikatorët e performancës (KPI)

- a) Si do të matet progresi?

Progresi do të matet përmes monitorimit periodik të disa treguesve kryesorë, si sasia e ambalazheve të grumbulluara, numri i orientimeve ose trajnimeve të realizuara për punonjësit, si dhe ndryshimet në konsumin e ujit dhe energjisë krahasuar me periudhën para zbatimit të masave. Krahasimi ndërmjet periudhave do të shërbejë për të vlerësuar përmirësimin gradual të performancës.

- b) Çfarë të dhënash do të raportohen?

Do të raportohen të dhëna bazë dhe të matshme, si sasia e mbetjeve të ndara dhe dorëzuara për trajtim, numri i incidenteve ose aksidenteve në punë, konsumi mujor i energjisë elektrike dhe ujit, si dhe zbatimi i rregullave të sigurisë në punë. Të dhënat do të mbahen në formë regjistrash të thjeshtë dhe do të përditësohen rregullisht.

- c) Kush do të monitorojë ecurinë?

Monitorimi i ecurisë do të realizohet kryesisht nga pronarët dhe menaxhimi i FITO FARM, të cilët kanë përgjegjësinë për kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të masave. Ata do të mbështeten nga punonjësit përgjegjës për magazinën dhe aktivitetet operative, duke siguruar që indikatorët të ndiqen në mënyrë të vazhdueshme dhe të përdoren për përmirësim të mëtejshëm.

## 6. Integrimi i Ekonomisë Qarkulluese

- a) Materialet që mund të riciklohen, ripërdoren ose ridizenjohen

Në aktivitetin e FITO FARM dalin materiale që mund të menaxhohen më mirë përmes ekonomisë qarkulluese. Materiali më problematik dhe njëkohësisht më i rëndësishëm është plastika e ambalazheve të pesticideve dhe plehrave kimike, e cila mund të grumbullohet në mënyrë të ndarë dhe të dorëzohet për trajtim të kontrolluar. Po ashtu, kartoni dhe ambalazhet plastike nga magazina mund të ndahen dhe të dërgohen për riciklim. Një element pozitiv që kompania e bën edhe sot është ripërdorimi i paletave dhe arkave për transport dhe magazinim, gjë që ul mbetjet dhe kostot. Në fermë, mbetjet organike nga agrumet, si fruta të dëmtuara ose mbetje pas seleksionimit, mund të përdoren në mënyrë të kontrolluar për rikthim të lëndës organike në tokë, duke përmirësuar strukturën e saj dhe duke reduktuar sasinë e mbetjeve.

- b) Mundësia për krijimin e një cikli të mbyllur të mbetjeve

FITO FARM ka mundësi të krijojë një cikël të thjeshtë të mbyllur të mbetjeve, vecanërisht në aktivitetin bujqësor. Rikthimi i mbetjeve organike në tokë ndihmon në shfrytëzimin më të mirë të burimeve të krijuara brenda vetë fermës dhe ul nevojën për inpute shtesë.

c) Modele të reja biznesi qarkullues (sharing, repairing, renting)

Edhe pse FITO FARM nuk operon si një biznes industrial, disa modele të thjeshta të ekonomisë qarkulluese mund të aplikohen në praktikë. Në aspektin e sharing, kompania mund të forcojë rolin e saj këshillues ndaj fermerëve, duke ndarë njohuri dhe praktika të mira për përdorimin e përgjegjshëm të inputeve bujqësore. Ky shkëmbim informacioni ndihmon në uljen e shpërdorimit të produkteve dhe në reduktimin e ndikimit mjedisor.

Në aspektin e repairing, mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve ekzistuese në magazinë dhe fermë përbën një praktikë të rëndësishme qarkulluese. Zgjatja e jetës së pajisjeve ndihmon në uljen e nevojës për blerje të reja, redukon mbetjet dhe ul kostot operative të biznesit.

d) Ndikimi në uljen e riskut mjedisor dhe financiar

Integrimi i ekonomisë qarkulluese në FITO FARM ndihmon drejtpërdrejt në uljen e riskut mjedisor, sidomos për shkak të menaxhimit më të mirë të mbetjeve.

Nga ana financiare, këto praktika ndikojnë në uljen e kostove operative. Ripërdorimi i materialeve të transportit dhe magazinimit ul shpenzimet për blerje të reja, ndërsa përdorimi më efikas i burimeve ndihmon në shmangien e humbjeve dhe shpenzimeve të panevojshme. Në afatgjatë, një menaxhim më i organizuar i mbetjeve dhe burimeve e bën biznesin më të qëndrueshëm financiarisht, sepse ul riskun e kostove të papritura (si dëme, penaltete apo shpenzime për rregullime emergjente) dhe përmirëson reputacionin e kompanisë te klientët dhe partnerët.

## 7. Ndikimet Sociale dhe Qëndrueshmëria Shoqërore

a) Ndikimi në mirëqenien e punonjësve

FITO FARM ka një ndikim pozitiv në mirëqenien e punonjësve. Paga në sezon është relativisht e lartë krahasuar me tregun lokal, cka ndihmon në motivimin e punonjësve dhe përmirëson sigurinë financiare të tyre. Marrëdhëniet në punë janë përgjithësisht korrekte dhe komunikimi me drejtuesit është i drejtpërdrejtë. Megjithatë, gjatë sezonit ngarkesa e punës rritet dhe kjo mund të ndikojë në lodhjen fizike të punonjësve, ndaj organizimi i pushimeve të shkurtra dhe planifikimi i orarit është i rëndësishëm për ruajtjen e mirëqenies.

b) Përmirësimi i barazisë gjinore

Nuk evidentohet diskriminim gjinor dhe punonjësit trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht gjinisë. Punësimi bazohet kryesisht në nevojat e punës dhe aftësitë, vecanërisht gjatë sezonit, ku si burra ashtu edhe gra përfshihen në procese të ndryshme si seleksionimi, paketimi dhe magazinimi. Ruajtja e këtij parimi të barazisë dhe krijimi i një mjedisi pune pa paragjykitime kontribuon në qëndrueshmërinë shoqërore të kompanisë.

c) Siguria në punë dhe standardet etike

Ndikimi më i madh social i planit lidhet me sigurinë në punë, sidomos në periudhat sezonale. Futja e disa rregullave të thjeshta të shkruara dhe një orientimi të shkurtër për punonjësit sezonalë ul riskun e incidenteve dhe e bën procesin më të kontrolluar. Nga ana etike, plani e

forcon përgjegjësinë e kompanisë në këshillimin e fermerëve, duke shmangur keqpërdorimin e inuteve dhe duke rritur korrektësinë në marrëdhënie me klientët dhe punonjësit.

d) Kontributi në komunitet

Kontributi social në komunitet lidhet me punësimin sezonal dhe mbështetjen indirekte të fermerëve të zonës përmes inuteve dhe këshillimit. Përmirësimet e propozuara, sidomos në menaxhimin e mbetjeve dhe përdorimin më të përgjegjshëm të produkteve, ndikojnë pozitivisht edhe te komuniteti, sepse reduktojnë shqetësimet mjedisore dhe rrisin imazhin e biznesit si i rregullt dhe korrekt.

e) Ndikimi i planit në reputacionin e kompanisë

Zbatimi i masave sociale dhe etike rrit reputacionin e FITO FARM, sepse krijon më shumë besim te punonjësit, klientët dhe institucionet. Një biznes që menaxhon më mirë sigurinë, e trajton stafin në mënyrë të drejtë dhe tregon kujdes për ndikimin në komunitet, shihet më serioz dhe më i qëndrueshëm në kohë. Kjo ndihmon edhe në ruajtjen e marrëdhënieve afatgjata me fermerët dhe partnerët tregtarë.

## 8. Përfundime dhe Rekomandime

a) Përfitimet kryesore të planit

Përfitimi kryesor i planit të veprimit lidhet me uljen e risqeve mjedisore, sociale dhe operacionale që ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e kompanisë. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve dhe ambalazheve të pesticideve redukton ndotjen mjedisore dhe riskun e penalteteve ligjore. Masat për sigurinë dhe mirëqenien e punonjësve rrisin stabilitetin e fuqisë punëtore, ulin aksidentet dhe përmirësojnë imazhin social të biznesit. Ndërkohë, rritja e efikasitetit në përdorimin e burimeve ndikon pozitivisht në uljen e kostove operative dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare. Në tërësi, plani kontribuon në përmirësimin e reputacionit të FITO FARM dhe në forcimin e marrëdhënieve me klientët, partnerët dhe institucionet.

b) Vlerësimi financiar i zbatimit

Nga pikëpamja financiare, zbatimi i planit të veprimit nuk kërkon investime të mëdha fillestare. Kërkon një investim fillestar të vlerësuar rreth 1500–2000 euro, i cili përfshin shpenzime për organizimin e menaxhimit të mbetjeve, pajisje minimale sigurie për punonjësit, përmirësime të thjeshta teknologjike si ndricimi LED dhe aktivitete orientuese për stafin. Këto investime janë të menaxhueshme për kompaninë dhe mund të shpërndahen në kohë. Përfitimet financiare shfaqen kryesisht në afat të mesëm dhe të gjatë përmes uljes së kostove operative, shmangies së gjobave apo shpenzimeve të paparashikuara dhe përmirësimit të efikasitetit të përgjithshëm të aktivitetit. Në këtë kuptim, plani paraqet një raport pozitiv kosto–përfitim.

c) Risqet e reja që mund të shfaqen gjatë implementimit

Gjatë implementimit të planit mund të shfaqen disa risqe të reja. Një risk i mundshëm është rezistenca ndaj ndryshimit, si nga drejtuesit ashtu edhe nga punonjësit, për shkak të mësimin me mënyrat tradicionale të funksionimit. Po ashtu, mund të lindin vështirësi në koordinimin e masave të reja gjatë periudhave me ngarkesë të lartë sezonale. Një tjetër risk lidhet me

mungesën e vazhdimësisë në monitorimin e treguesve të performancës, nëse nuk i kushtohet vëmendje e mjaftueshme dokumentimit. Megjithatë, këto risqe janë të menaxhueshme përmes komunikimit të mirë, angazhimit të drejtuesve dhe planifikimit gradual të masave.

d) Rekomandime për periudhën 1–5 vjeçare

FITO FARM duhet të synojë zhvillim të qëndrueshëm, duke ruajtur përputhshmërinë me ligjet dhe rregullat e reja që lidhen me mbrojtjen e mjedisit. Një hap i rëndësishëm është që kompania të krijojë një mënyrë të thjeshtë për të ndjekur ndryshimet ligjore dhe kërkesat mjedisore, në mënyrë që aktiviteti i saj të mbetet gjithmonë i rregullt dhe i përgatitur për standarde të reja apo kontrole.

Gjithashtu, FITO FARM duhet të qëndrojë e informuar mbi politikat publike, programet mbështetëse dhe mundësitë e financimit që ofrohen për bizneset që investojnë në mbrojtjen e mjedisit. Duke ndjekur këto politika dhe duke bashkëpunuar me institucione lokale ose ekspertë, kompania mund të përfitojë nga grante, subvencione dhe projekte që ndihmojnë në uljen e kostove të investimeve të gjelbra.

Një tjetër rekomandim është që FITO FARM të luajë një rol më aktiv në ndërgjegjësimin e klientëve dhe fermerëve për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit. Duke qenë se kompania nuk mund ta realizojë e vetme qëndrueshmërinë mjedisore, ajo duhet të kontribuojë në informimin dhe orientimin e klientëve mbi përdorimin e përgjegjshëm të pesticideve dhe plehrave kimike, menaxhimin e ambalazheve dhe respektimin e praktikave më të sigurta bujqësore. Përmes këshillimit, komunikimit dhe shembullit praktik, FITO FARM mund të ndikojë pozitivisht në sjelljen e klientëve dhe partnerëve të saj, duke krijuar një qasje të përbashkët për mbrojtjen e mjedisit. Kjo do të ndihmojë jo vetëm në uljen e ndikimit negativ mjedisor, por edhe në forcimin e reputacionit të kompanisë si një agrobiznes i përgjegjshëm dhe i orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

8. Anekset




Figura 1: Skemë se si mund të organizohet ndarja e mbetjeve




Figura 2: Skema e zinxhirit të aktivitetit të FITO FARM

Punoi:

Emilios Zote

Tenida Kaleshi

Pranoi:

Prof. Asoc. Dr. Perseta Grabova